

# Rendimenti i lartë ditor tregon rentabilitet në stallë

*Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe aksioner i AUSTRIA  
Prämix shpk*



***Rendimenti i lartë jetësor** është i rëndësishëm për të gjykuar rentabilitetin por a është rendimenti i lartë ditor vendimtar? Për të përlllogaritur rendimentin ditor përpjesëtohet sasia totale e qumështit të prodhuar (kg) me numrin e ditëve të jetës. Në këtë mënyrë konstatohet rendimenti jetësor duke ju bazuar jetëgjatësisë.*

Karakteristike në krahasim me kriteriet e tjera si p.sh. prodhimi mesatar vjetor, rendimenti jetësor ose zgjatja e përdorimit, është për rendimentin ditor edhe rritja e kafshëve të reja. Rendimenti ditor përfshin tre parametrat e mëposhtem, të cilat për ekonomine e prodhimit të qumështit janë me rëndësi të njëjtë:

- gjatësia e lartë e përdorimit
- rendimenti të larte laktacioni
- mosha e ulët në pjellën e parë dhe arritja e hershme në ushqyerjen e dytë me gji

## **Rritja e viçave- themelet për rendiment ditor të lartë**

Fermat me rendiment të lartë ditor raportojnë se përkujdesja e viçave duhet bërë me një masë të madhe disipline, në mënyrë që rezervat e kafshëve të mbahen sa më gjatë. Rendimenti ditor i lartë, fillohet me një rritje optimale të viçave, meqënëse viçat e sotëm janë lopët tona të së nesërme. Kusht kryesor është lindja pa stres dhe në kushte higjienike. Zona ku rri viçi duhet të pastrohet rregullisht nga papastërtitë dhe të jetë e shtruar mirë me kashtë. Sa më steril të jetë mjedisi përreth, aq më i ulët do të jetë rreziku për infektimin e viçit të sapolindur.

Meqënëse viçi në castin e lindjes nuk ka sistem imunitar të vetin, i ofrohet imunizimi pasiv me kulloshtër. Gjatë kësaj kohe bëhet nisja e të paktën 2l, në rastin më të mirë 3l kulloshtër. Koha që i duhet globulinës për tu përthithur nga murret e zorrëve është shumë e vogël. Në 8 orët e para pas lindjes, aftësia e asorbimit të mureve të zorrëve përgjysmohet në krahasim me tre orët e para. Në të njëjtën kohë reduktohet edhe përqëndrimi i antitropave nga mjelja e parë në të dytën. Për të siguruar një furnizim optimal me kulloshtër, këshillohet të mbahet e ngrirë një sasi kulloshtër e cilësisë së lartë. Më pas ndërrohet me pijen e rradhës. Në rast se do të jetë qumësht, është e domosdoshme shtimi i disa substancave për të siguruar furnizimin e nevojshëm me hekur, vitamina dhe bioelement. Kur jepet një zëvendësues qumështi, duhet të plotësojë të paktën kërkesat minimale: 20% proteinë të papërpunuar, 10-20% yndyrë, < 10% hi. Zëvendësuesi i qumështit duhet të arrijë në 160g për 1l ujë deri në javën e gjashtë të lindjes dhe më pas 125-130g për cdo l ujë.

Mbetet për tu konsideruar, se për një tretje më të mirë, zëvendësuesi i qumështit duhet të përmbajë në gjysmën e parë të periudhës së pirjes, një sasi të madhe të proteinave të qumështit. Për të garantuar stabilizimin e shëndetit të kafshës gjatë periudhës së pirjes është e këshillueshme thartimi i pijeve (p.sh. me acid formik, acid citric ose uthull frutash etj). Përgjatë përdorimit të acideve duhet zbatuar me rigorozitet mënyra e përdorimit. Paralel me periudhën e pirjes, mbas ditës së 8-të të lindjes, kafshët duhet të kenë dalje të lirë për të pirë ujë dhe tu jepet ushqim i cilësisë së lartë, i fortë dhe i mirëstrukturuar. Në javët e para të jetës kafshët duhet të mbahen në bokse individuale (igloo, kafaze) me kontakt viziv dhe të prekshëm me kafshët e tjera. Pra kështu është qëndrimi në grup i zakonshëm. Madhësia e grupit varet nga kushtet e fermës. Në aspektin

higjenik parapëlqehen më shumë grupet e vogla. Sistemi brenda-jashtë me pastrim, dezinfektimi dhe hapsirat e lira, parandalon infektimin në moshat e reja.

Vëzhgimet intensive dhe të rregullta të kafshëve lejojnë zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe veprimin në kohë. Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes shfaqen më shpesh. Kjo mund të parandalohet me një klimë stalle të mirë. Nga faktorët që ndikojnë përmendim: gazrat helmuese, lagështia e ulët e ajrit, pluhuri dhe korentet e ajrit. Mbajtja në ambjentet e jashtme të stallës, por në një strukturë në igloo (bokse për viça), e cila krijon një mikroklimë, është konstatuar në praktikë si sistemi më optimal. Diarreja është problemi i dytë më i madhë në rritjen e viçave. E nevojshme është higjena shumë e mirë gjatë lindjes dhe ushqyerja optimale me kullosh të. Në rast diarreje merren mostra të fekaleve për përcaktimin e shkaktarit dhe merren masat e nevojshme për kurim. Shkaktarët më të shpeshtë që cojnë në diarre janë: viruset (Rota/Corona), parazitët (si psh. Coccidian, cryptosporidium).

### **Rritja e bagëtive të reja- një hap për prodhim të lartë ditor**

Qëllimi kryesor i rritjes së bagëtive të reja është rritja e lopëve me rendiment të lartë për qumësht. Pjella optimale nga 24 deri në 26 muajshe, me peshe 630 kg, arrihet vetëm me një rritje të vazhdueshme. Rritja e bagëtive të reja në ferma me rendiment të lartë, arrihet vetëm me zbatimin e këshillave konkrete. Të rëndësishme janë kontrollet ditore të bagëtive për të dalluar herët ndryshimet. Ushqyerja e bagëtive të reja duhet të ndiqet nga parimi “Në fillim shtyhet dhe pastaj frenohet”. Normal është shtimi në peshë nga 1000- 1200 g në ditë edhe para muajit të 9-të.

Në tabelën e mëposhtme është e dukshme ngjashmëria e sasisë së ushqimit të përzierë të viçave deri në 350 kg, në lidhje me kërkesat për lëndë ushqyese të lopëve me qumësht.

		<b>Viça mbi 150 kg</b>	<b>Lopët e qumështit 22 kg Qumësht/Ditë</b>	<b>Viça mbi 350/400 kg</b>	<b>Lopë qumështi e tharë</b>
<b>ME</b>	MJ/kg TM	10,7	(10,7)	9,8	(8,8)
<b>NEL</b>	MJ/kg TM	---	6,5	---	5,3
<b>XP</b>	g/kg TM	140	(165)	120	(120)
<b>nXP</b>	g/kg TM	---	142	---	110
<b>CA</b>	g/kg TM	7,5	5,4	4,8	4,0
<b>P</b>	g/kg TM	3,5	3,4	2,6	2,5

Në të njëjtën kohë racioni ushqimor me përmbajtje të ulët energjike e lopës në tharje, të përdoret në vitin e dytë të rritjes. Për bagëtitë e reja nuk duhet të përdoren racione të veçuara. Duhet të garantohet në cdo rast një furnizim i mjaftueshëm me lëndë minerale. Balanca kalcium-fosfor e kafshës së rritur ka rëndësinë më të madhe. Për tu vënë re, përsa i përket pjellorisë, në fazën e dytë të rritjes duhet të bëhet furnizimi me vitamina dhe minerale. Gjithashtu edhe këtu vlen rregulli themelor që ushqimi dhe uji që ofrohet duhet të jetë i bollshëm dhe higjenikisht i pastër. Vetëm kështu kafshët do të kenë rendiment të lartë. Kontrolli më i rëndësishëm në këtë grupmoshë është kontrolli i rregullt i peshës për mos të kaluar peshën optimale të mbarësimit që është 400-420 kg. Kjo mund të bëhet shumë thjeshtë me metër për matje ose hipometër. Për të siguruar zhvillim optimal, kafshët duhet të mbahen deri në moshën 6 muajshe në stalla ose kasolle të shtruara mirë me kashtë. Është e këshillueshme mbajtja e kafshëve në stalla në gjendje të lirë. Kjo ka përfitime ekonomike dhe kafshët mësohen në një fazë të hershme në bokse të vecuara. Mbajtja e kafshëve në zgara betoni sidomos para muajit të gjashtë të jetës, sjell disavantazhe në sistemin imunitar dhe në shtimin ditor në peshë. Vecanërisht për tu pasur kujdes është luftimi konstant i parazitëve Endo-Ekto. Në një tufë e cila mbahet gjatë gjithë vitit në regjim stallor, ka treguar në praktikë që mbizotëron domosdoshmëria për funksionimin e përkujdesjeve ndaj thundrave dhe trajtimit kundër sëmundjes së mortellarit.

### **Mbarështimi i lopëve të qumështit- si ta dërgoj lopën time në laktacionin e rradhës?**

Një lopë bëhet fitimprurëse vetëm pas laktacionit të tretë sepse deri atëherë mbulon vetëm koston e rritjes. Prandaj është e rëndësishme që kafshët të mbahen në gjendje të mirë sa më gjatë të jetë e mundur. Pikësynimi kryesor është që kafshët, nepërmjet një menaxhimi të suksesshëm të tufës, të mbahen të shëndetshme dhe me rendiment maksimal.

### **Dy fazat e periudhës së tharjes**

Periudha e tharjes është e rëndësishme për rigjenerimin e indeve të gjirit.

1. Faza e parë: Java e 8-të para pjelljes: ushqim për sigurim energjie, kalcium dhe kalium, furnizim të mjaftueshëm me magnezium, vitaminë E dhe selen
2. Faza e dytë: Dy javë nga pjellja deri në pjellje: përshtatja e bakteve të Rumenit me komponent me përmbajtje energjike të lartë duke ju përshtatur racionit ushqimor për lopë qumështi
3. Ndarja e kafshëve për pjellje në vende të vecanta me kashtë
4. E nevojshme qasja në ujë të pastër dhe ushqim

## **Pjellja dhe periudha pas pjelljes (10 ditë)**

- Të bëhet kujdes me higjenën gjatë lindjes
- Ndarja e shpejtë e lopës dhe viçit
- Marrja sa më shpejtë të jetë e mundur e ushqimit dhe ujit pas pjelljes
- Për kontroll sa më të mirë të kafshëve mbajtja në grupet e lopëve të sapopjella
- Kontrolle ditore të temperatures
- Kontroll i rregullt i sekrecioneve të uterusit dhe sistemit metabolik; sipas konsultave të nevojshme me veterinerin e zonës.
- Ushqyerja: Për të shmangur deficiete të mëdha energjie gjatë lindjes, mund të jetë i nevojshëm shtimi i ushqimeve energjike.
- E rëndësishme është që lopa të fillojë të ushqehet sa më shpejtë të jetë e mundur.

## **Pjelloria dhe mbartja**

- Është thelbësore që kafshët të pastrohen sa më shpejtë të jetë e mundur, në mënyrë që të kryhet mbartja. Në fund të ditës së 60 duhet të kryhet mbartja.
- Kafshët që nuk vijnë në afsh ose jombartëse, të diferencohen dhe të mbahen në vëzhgimin e veterinerit.

## **Ushqyerja**

- Ushqyerja e drejtë gjatë laktacionit në varësi të të dhënave individuale nga kontrolli i rendimentit të qumështit.

## **Rutina dhe instrumentet e kontrollit të vëzhgimit të kopesë**

- Shqyrtimi i gjendjes metabolike të lopëve që sapo kanë pjellë, psh. me një test ketoze
- Vëzhgim i përgjithshëm i kopesë: sasisë së qumështit dhe vëzhgim i përbërësve të qumështit
- Raportim i kontrollit mbi rendimentin e qumështit të çdo kafshe.
- Vëzhgime intensive të kafshëve në stallë sidomos deri në mbartjet e tjera.

Si përfundim, pika më e rëndësishme për të rritur prodhimin ditor është një monitorim i vazhdueshëm i kafshëve gjatë rritjes dhe laktacionit. Kjo është një masë e nevojshme për kontrollin e kafshëve dhe vëzhgimin e tyre. Trajtimet e nevojshme nuk duhet të shtyhen.

Sipas motos: „**Ne nuk bëjmë asgjë jashtë të zakonshmes, vetëm atë që ne bëjmë, e bëjmë në mënyrë të veçantë**“.